



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0987

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Ud.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen Kimete Gashi Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE “DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.”, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”, më 20/12/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Doctor Exterminator” Sh.P.K. kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës

2. Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi ashtu që të korrigojë dosjes e tenderit sipas të gjeturave në arsyetim, si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

3 Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrij kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrihet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 19.09.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “36 DDD objekteve te KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për shërbim, me vlerë të parashikuar 80,000.00€. Me datë 03.10.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim disa kërkesave të dosjes së tenderit, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 08.10.2024.

Me datë 15.10.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0826.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë si vijon:

Pretendimi 1. – *“OE ankues ndër të tjera pretendon se në piken 7.1& 7.2 per pershtatshmërinë profesionale ne piken 5 dhe 6 te FDT janë vendosur kritere diskriminuese, ku per piken 5 e konteston leshimin e qertifikatave ne verzionin e gjuhes shqipe sepse keto qertifikata leshohen ne gjuhen angleze ,ndersa për piken 6 i konteston dy iso standarde si ISO 9001-2018, ISO 140001 - 2018,se nuk ekzistojn fare ,shihë kriteret e kontestuara nga OE ankues”.*

Pretendimi 2. – *“OE ankues ndër te tjera pretendon se kerkesa e vendosur lidhur me kontratat dhe referencat është e pa qart sepse i njejti nuk e kupton termin produkte te perfshira dhe kerkon te zevendesohet termi produkte me termin sherbime”.*

Pretendimi 3. – *“OE ankues ndër te tjera pretendon se kriteri i vendosur per emidemiolog qe kerkohet diplomë universitare e jo licencë dhe i njejti pretendon se ingjineri sanitar nuk është i nevojshëm,si dhe e konteston kriterin per 10 puntor te trajnuar ne menaxhimin e kontrollit te demtuesve (pest Control&Menagment)”.*

Pretendimi 4. – *“OE ankues ndër te tjera pretendon se kriteri i vendosur per pajisje është diskriminues dhe favorizues per ndonje OE qe i ka keto pajisje”.*

Pretendimi 5. – *“OE ankues ndër te tjera pretendon se kriteri i vendosur per 15 puntor staf te certifikuar per siguri dhe shendet ne punë është e pa nevojshme për aktivitetin e prokurimit”.*

Pretendimi 6. – *“E ankues ndër te tjera pretendon se kriteri i vendosur per „Leje per import është diskriminues dhe favorizues dhe i njejti duhet te hiqet komplet pasi nuk ka specifika teknike per produkte biocide insecticide”.*

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 25.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 07.11.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim”*.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimin nr. 1 – *“Ekspertja sqaron se qendron pretendimi i OE ankues sepse qertifikatat e leshuara në gjuhen angleze janë te pranueshme edhe me dispozitat e LPP-së, mirëpo AK mundë te kerkojë zgjidhje ekuivalente, nese te njejtat leshohen ne gjuhen angleze duhet te perkthehen nga perkthyesit e licencuarë dhe të dorëzohen edhe në gjuhen shqipe të perkthyer, andaj pretendimi për piken 5 trajtohet si i bazuar. Edhe pretendimi për piken 6 trajtohet i bazuar sepse kemi bërë hulumtime nuk kemi hasur ne këto ISO 9001-2018, ISO 140001 -2018, por ekspertja udhezohet AK qe me rastin e korrigjimit të dosjes se tenderit te sigurohet se te njejtat qertifikata a ekzistojn apo nuk ekzistoj fare siq pretendon OE ankues,nga hulumtimet e shumta jam ardhur në përfundim se te njejtat nuk ekzistojn dhe udhezohet AK qe edhe një here ta verifikoj se mos ka gabuar ne numra apo në vitet e leshimit te ketyre certifikatave”*.

Lidhur me pretendimin nr. 2 - *“Ekspertja sqaron se pjeserisht qendron pretendimi i OE ankues edhe pse kjo është e kuptueshme se behet fjalë per listen e kontratave që perfshinë sherbime te ngjaishme por sidoqoft OE ankues e ka shfrytezuar te drejtën me kontestua ketë term, andaj udhezohet AK që ta modifikojë ku ne vend të produkteve ta zavendesoj me termin sherbime nese ankesa aprovohet nga Paneli Shqyrtues”*.

Lidhur me pretendimin nr. 3 - *“Ekspertja sqaron se AK ka dhenë pergjigjeje te detajuar per secilin pretendim duke e arsyetuar pse është vendosur secili kriteret madje duke dhenë arsye qe ndikon për te mirën e institucionit dhe te stafit te brendshëm dhe të jashtëm andaj konsideroj se arsyetimi i AK qendron dhe pretendimet e OE ankues nuk janë te pranueshme”*.

Lidhur me pretendimin nr. 4 - *“Ekspertja sqaron se pjeserisht qendron pretendimi i OE ankues sa i perket percaktimit te pajisjeve sepse AK ka percaktua saktminimum nje ULVmin. ULV aerosol elektrik me dy rezervuar 6.5 litersh&20liter,ky kriter është i pa pranueshëm dhe qendron pretendimi i OE ankues sepse e njejta mbushet dhe nuk është e nevojshme te jetë fiks me litra por i njejta duhet te ketë një tolerancë e jo te percaktohet sepse kriteret aty ku është mundesia duhet te tolerohet nje limit e jo te percaktohet sakt sepse nuk është e rendesishme per AK a është kjo pajisje 6.5 apo 7.5 apo 5.5 , e sa i perket pretendimeve te tjera nuk qendrojn pretendimet e OE ankues ,sepse qendron arsyetimi i AK sepse per pajisjet e tjera ka alternativa siq janë theksuar ne kriterë deshmit e pronesisë apo marrveshjet e qirasë”*.

Lidhur me pretendimin nr. 5 - *“Ekspertja është e mendimit se kerkesa per 15 puntor staf te certifikuar per siguri dhe shendet ne punë është e pa nevojshme për aktivitetin e prokurimit,*

kerkesa do ishte e pranueshme për ndertime te larta e ne rastin konkret konsideroj se është e pa nevojshme dhe jo profesionale per aktivitetin ne fjalë ,e njejta duhet te hiqet komplet apo te ketë vetem një numer minimal që nuk do ti kalonte 2 apo tre persona te tillë”.

Lidhur me pretendimin nr. 6 - *“Ekspertja sqaron se i ka analizuar specifikat teknike dhe nuk ka verejtur se janë kerkuarë biocide insekticide, andaj edhe kerkesa për leje te importit te ketyre produkteve konsiderojë se nuk është e nevojshme pasi që te njejtat edhe nuk janë kerkuarë me specifika teknike siq pretendon OE ankues”.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përdërisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtresues i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin nr. 1 - Paneli Shqyrtues i ka falur vetëm pjesërisht besimin sqarimeve të ekspertit shqyrtues për faktin që ISO 9001:2018 është standard në kuadër të familjes ISO 9001 i cili ka të bëjë me “Quality Management Audit” ndërsa te ISO 14001:2018 i cili ka të bëjë me menaxhimin e sistemeve mjedisore, në dosjen e tenderit është shënuar numri 140001 dhe jo

14001. Pra qëndron konstatimi se ISO 140001:2018 nuk ekziston. Prandaj AK duhet të rishikoj nëse kërkesa për këto ISO fillimisht janë të domosdoshme, pastaj duhet të rishikoj numrat e këtyre standardeve të vendosura në DT. Mbi bazën e këtij fakti AK do të vendos që të korrigjoj këto ISO duke ndryshuar numrat apo që të njëjtat t'i largoj në tërësi. Përndryshe kërkesa për ISO është diskrecion i autoritetit kontraktues mirëpo i cili duhet të ushtrohet në përputhje të plotë me nenin 70 të LPP lidhur me standardet për sigurimin e cilësisë. Pretendimi ankimor është vetëm pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 2 - Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ekspertit shqyrtues sipas të cilave rezulton se pretendimi ankimor është i bazuar. Prandaj me rastin e korrigjimit të dosjes së tenderit, te kërkesa lidhur me kontratat e realizuara në 3 vitet e fundit, në pjesën e dëshmisë dokumentare duhet të zëvendësoj termin “produkte” me termin “shërbime” pasi që në rastin konkret aktivitet është kontratë për shërbime dhe jo për furnizime.

Lidhur me pretendimin nr. 3 Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ekspertit shqyrtues sipas të cilave rezulton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 4 Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ekspertit shqyrtues sipas të cilave rezulton se pretendimi ankimor është i bazuar. Më konkretisht AK duhet të korrigjoj dosjen e tenderit ashtu që te kërkesa “*ULVmin. ULV aerosol elektrik me dy rezervuar 6.5 litersh&20liter*” te pjesa e kapacitet duhet të lejoj një minimum dhe maksimum sepse nuk mund të përcaktohet kapaciteti në mënyrë fikse sikurse në rastin konkret.

Lidhur me pretendimin nr. 5 Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin elaborimeve të ekspertit shqyrtues pasi që AK ka diskrecionin por edhe përgjegjësinë për të identifikuar saktë kërkesat mbi kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional me qëllim që të realizohet kontrata në mënyrën më efikase dhe efektive të mundshme sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket kërkesës konkrete, AK ka lejuar që tenderuesit të ofertojnë edhe me punonjës me të cilët ka lidhur parakontrata. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 6 Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin elaborimeve të ekspertit shqyrtues pasi që eksperti shqyrtues konstaton që sipas specifikave teknike të DT nuk janë kërkuar biocide dhe insekticide prandaj nuk është e nevojshja leja për importimin e tyre. Në anën tjetër Paneli Shqyrtues ka gjetur se në rastin konkret nuk ka fare specifika teknike por vetëm paramasa ku duhet të vendoset çmimi i përgjithshëm. Pra konstatimi i ekspertit është i pasaktë objektivisht. Në anën tjetër aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim (DDD) ku është e domosdoshme që të përdoren insekticide dhe biocide. Prandaj lidhur me këtë pretendim ankimor Paneli Shqyrtues i ka falur besimin sqarimeve të ofruara nga AK në vendimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprjë në mënyrë proporcionale me shkëljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke*

përfshirë interesin publik". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet pjesërisht e bazuar ashtu që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës duhet të korrigjoj kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "36 DDD objekteve te KPSH" me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1 sipas të gjeturave të elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: